



VENDIM

Nr. 75, Datë 26.05.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 25, DATË 15.02.2017 “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR. 103 DATË 23.06.2016 , “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, gërma “1”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.05.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Bordit të ERE nr.25, datë 15.02.2017 “Mbi miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të Vendimit të Bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE nr.103, datë 23.06.2016, Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

Konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19 gërma “1“ ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë

elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik,

- OSHEE sh.a. ka kërkuar me shkresën nr.12136 Prot., datë 15.05.2017, shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të rregullores së miratuar me Vendimin nr.103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE,
- OSHEE sh.a. bën me dije se grupi i punës i ngritur nga OSHEE ka filluar punën me qëllim krijimin e platformës online për prokurim/blerjen online të energjisë elektrike dhe është hapur procedura me objekt “ ndërtimi i platformës elektronike të publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike.
- Oshee sqaron se, duke marrë parasysh afatet ligjore që parashikon ligji i prokurimit publik “... *autoriteti kontraktor fton operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën jo më vonë se 60 ditë nga data e publikimit*” si dhe të depozitojë dokumentat standarte të tenderit ku kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor i ekzekutimit është 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.
- ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE nr. 103 datë 23.06.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër: Bordi i ERE

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të vendimit të Bordit të ERE Nr. 25, Datë 15.02.2017 si më poshtë :
 - “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar

përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin nr.103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE, hyn në fuqi brenda datës **31.07.2017**.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

REPUBLIKA E SHQIPERISE

VENDIMIN

Nr. 75, Datë 26.05.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 25, DATË 15.02.2017 “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR. 103 DATË 23.06.2016 , “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Entela Shehaj

Abaz Aliko

Maksim Shuli
